


# Udhëzues i shpejtë për vaksinën ndaj koronavirusit

Informacion i shkurtër nga Instituti Norvegjez i Shëndetit Publik në lidhje me vaksinën kundër COVID-19 (koronavirus).

---




## Rreth vaksinimit për koronavirus

Vaksina do të ofrohet për të gjithë ata që rekomandohet ta marrin vaksinën.

Vaksina është falas.

Vaksina mbron nga COVID-19.

---




## Si bëhet vaksinata?

Vaksina jepet në formën e injektimit në krah.

Disa nga vaksinat jepen në dy doza, dy javë larg njëra-tjetrës.

Mos harroni të tregoni nëse jeni shtatzënë, keni alergji, nëse përdorni medikamente, nëse jeni sëmurë ose keni pasur COVID-19.

---



## Sa e efektshme është vaksinata?

Shumica e njerëzve janë të mbrojtur nga COVID-19 brenda 1-2 javësh pasi të jenë vaksinuar plotësisht.

Edhe pse jeni të vaksinuar vazhdoni të ndjekni këshillat për të ndaluar përhapjen e infeksionit.




## Si funksionon vaksina?

Vaksina i tregon trupit si ta dallojë koronavirusin dhe si të mbrohet prej tij.

Vaksina eliminohet shpejt nga trupi.

Megjithatë, trupi mban mend si të mbrohet nga virusi.




## Efektet anësore

Vaksina është testuar në studime të mëdha me mijëra njerëz. Efektet anësore të zakonshme janë:

- dhimbje në vendin e injektimit
- këputje
- dhimbje koke
- dhimbje trupi
- temperaturë ose ethe

Këto efekte anësore janë të sikletshme, por largohen brenda pak ditësh.



## Efektet anësore të pazakonta

Kontaktoni me mjekun ose me një profesionist të shëndetësisë nëse pas vaksinës keni simptoma të papritura, të rënda ose që zgjatin.